

VENDIM
Nr. 194, datë 30.12.2016

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË OST SHA LIDHUR ME
MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN
E TRANSMETIMIT, SHËRBIMET NDIHMËSE DHE DISBALANCAT**

Në mbështetje të neneve 1; 16 dhe 62, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM nr. 244, datë 30.3.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.12.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me kërkesën e OST sh.a. nr. 701/1 prot., datë 14.10.2016, OST sh.a., për problematikën mbi mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektro-energjitik, konstatoi se:

- Aktualisht në tregun shqiptar të energjisë elektrike vetëm njësitë gjeneruese të të licencuarit KESH sh.a. mund të shërbejnë për sigurimin e shërbimeve ndihmëse.
- Neni 1 i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikon se: “Qëllimi i këtij ligji është garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit”;
- MEI, me shkresën nr. 4514/1 prot., datë 3.8.2016, ka dërguar në ERE qëndrimin e saj lidhur me kërkesën e OST sh.a., për lënien të pandryshuar edhe për 6-mujorin e dytë të vitit 2016 të çmimit të energjisë elektrike që OST sh.a. i paguan KESH sh.a. për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit.
- ERE ka kërkuar edhe në vijim opinionin e MEI-t në lidhje me kërkesën e OST sh.a. nr. 701/1 prot, datë 14.10.2016, OST sh.a., për problematikën mbi sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjitik, duke konstatuar të njëjtat rrethana dhe kushte që lidhen me shërbimet ndihmëse dhe sigurimin e humbjeve në sistemin e transmetimit.
- Me vendimin nr.190, datë 22.12.2016, u vendos lënia në fuqi e vendimit nr. 145, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a për vitin 2015”. (Tarifë kjo e cila reflekton sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe humbjeve në rrjetin e sistemit të transmetimit përmes KESH sh.a.)

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. OST sh.a. të lidhë kontratë bilaterale me pjesëtarin e tregut KESH sh.a., për të siguruar shërbimet ndihmëse dhe të balancimit për vitin

2017, sipas marrëveshjes së miratuar me vendimin nr. 79, datë 7.6.2016, “Për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjitik”, midis OST sh.a. dhe KESH sh.a. dhe në përputhje me çmimin e përcaktuar sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 141, datë 26.12.2014.

2. Deri në miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, për të cilën kanë filluar procedurat me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 191, datë 22.12.2016, për qëllime të prokurimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, OST sh.a. të sigurojë humbjet nga KESH sh.a. në përputhje me përcaktimet e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit, miratuar me vendimin nr. 78, datë 7.6.2016, të Bordit të ERE-s.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

